

Shkodër: Vritet me silenciator ish-deputeti, u qëllua teksa ishte me bashkëshorten

Nga Bepin Kolvata | Përditësimi i fundit 29 Nëntor 2021, 20:09

Ish-deputeti Pashko Ujka, njëherësh edhe ish-kryetar i komunës së Velipojës mbeti i vrarë pas një atentati me armë me silenciator pranë banesës së tij në Shkodër. 64-vjeçari të cilit më parë i janë bërë edhe dy atentate, ka marrë një plumb në shtyllën kurrizore të cilit nuk i mbijetoi dot në spital ndërsa dëshmitare e gjithë ngjarjes ka qenë edhe bashkëshortja e tij. Policia po heton për konflikte personale por edhe sulm për shkak të detyrave që Ujka ka mbajtur në të kaluarën si deputet dhe si i zgjedhur vendor në Velipojë.

Ish-deputeti Pashko Ujka, njëherësh edhe ish-kryetar i komunës së Velipojës, është vrarë me armë pasditen e të hënës, 29 nëntor në Shkodër pranë banesës së tij.

Policia tha se ngjarja ndodhi në orën 18:15 pranë banesës së ish-deputetit të Aleancës Demokratike dhe më pas i PDK-së në lagjen Vasil Shanto, ku viktima ka qenë bashkë me të shoqen. Sipas dëshmitarëve dhe policisë, autorët përdorën një armë me silenciator ndërsa bashkëshortja e 64 vjeçarit e kuptoi se ai ishte qëlluar vetëm pas Ujka u rrëzua përtokë.

Menjëherë pas mbërritjes së policisë në vendin e ngjarjes, ish-deputeti është dërguar në spital ku disa orë pas ngjarjes, ndërroi jetë pasi nuk arriti t'i mbijetojë plagës së marrë e cila i kishte prekur shtyllën kurrizore.

Viktima ka shërbyer edhe si kryetar komune në Velipojë në vitet 2011-2015 ndërkohë që shërbimet e Policisë së Shkodrës kanë nisur hetimet në lidhje me ngjarjen dhe kanë kryer krehjen e zonës me qëllim kapjen e autorit.

Nga ana tjetër policia ka njoftuar edhe prokurorinë e Shkodrës e cila ka marrë drejtimin e hetimeve për zbardhjen e ngjarjes.

ARTIKULL I NDERLIDHUR



Atentat ish-kreut të komunës së Velipojës, spitali kërkon gjak të grupit A negativ



Iu bë atentat me silenciator, Ujka ish-kryetar komune dhe ish-deputet i PDK-së

Pistat e hetimit në lidhje me ngjarjen, kanë të bëjnë me konflikte personale të ish-deputetit Pashko Ujka, por edhe detyra e tij si kryetar komune në Velipojë, ku mësohet se ka pasur disa denoncime për çështje pronash.

Në vitin 2005 Pashko Ujka është zgjedhur deputet me aleancën demokratike ndërsa në 2007 ka kaluar me Partinë Demokratiane.

Në vitet 2008-2009 ai ka qenë pjesë e grupit parlamentar të PD. Në vitin 2016, Pashko Ujka ka kërkuar në Gjykatën Administrative shfuqizimin e dënimit të vendosur ndaj tij me gjobë nga Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve dhe Ujërave, Dega Rajonale Shkodër, por kjo kërkesë e tij është hedhur poshtë nga togat e zeza.

LIVESTREAM

ORA TV

ORA NEWS

RADIO ORA

LAJMI I FUNDIT

10:27

Franca e kërkonte për vjedhje, arrestohet 44-vjeçari kosovar në Morinë

10:02

Kanabis i ndarë në doza, arrestohet 22-vjeçari në Gjirokastrë. Procedohet një tjetër

09:59

Me 30 kg kanabis gati për shitje, 3 të arrestuar në Vlorë

09:55

Vodhi "Mitsubish-in" dhe po e drejtonte në gjendje të dehur,

Të gjitha lajmet e fundit

ME RENDESI

Greqia ndryshon masat, ndalon hyrjen e shtetasve nga vendet e treta. Çfarë ndodh me Shqipërinë?

Lexo artikullin →

Newsletter

Regjistrohu për të marrë i pari lajmin e fundit me email.

REGJISTROHU

ME TE LEXUARAT

1

SPORT

Çfarë klasi Armando Broja. Shikoni golin e radhës për bomberin kuqëzi në Premier League

2

LIFE&GOSSIP

Mandi Nishtullës tha se Silva e Dafi i vodhën lekët, këngëtarja mes lotësh nxjerr kontratën dhe plas bombën: Lekët i merr...

3

BOTA

E torturoi deri në vdekje, fëmija i lutej për bukë/ Burgim të përjetshëm për njerikën që vrau 6-vjeçarin, 21 vite burg për babanë

EMISIONET

POLITIKË

JOÇOLI

JU FLET MOSKA

KAŠTIRIOT MYFTARAJ

INTERVISTA

TRENDING NE RRJET

Xhensila Myrtezaj në një intervistë të pazakontë me kunistën, rrëfen për sipërmarrjen

Parashikuesja Irini: Do bjeri tërmet i fuqishëm, Shqipëria do...

Dikur Maya punonte në fabrikat e Gjermanisë, rrëfimi i këngëtares: Më mirë të punoja pastruese

Habit Roza Lati: Kjo është epoka e Bora Zemanit, e favorizoi zoti

Na ndiqni edhe në

ORA NEWS

TV Ora News është televizion lider në tregun e medias informative me një eksperiencë dhe kontribut 14 vjeçar në shërbim të shqiptarëve, kudo që jetojnë brenda dhe jashtë kufijve.

Channel One shpk - Rr."Aleksander Moisiu" Nr 76, Tirana, Albania
Administrator: Anxhela Babalieu
NIPT: K12412002L
Registered at Tirana, Albania
Email: info@oranews.tv
Phone +355 42 34 7577

RRETH NESH

KONTAKT

PUNESOHU

PRIVACY POLICY

COOKIES

ENGLISH

Built and Monetized by